



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/168
Datë: 23.10.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 20/165, të datës 12 tetor 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.2 e Vendimit të Qeverisë Nr. 20/165, të datës 12 tetor 2023, me tekstin, si në vijim:
 - 1.2. Togfjalëshi "dhe zëvendësanëtar Ersan Qavolli," Zëvendësohet me togfjalëshin "dhe zëvendësanëtar Isuf Sadiku".
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 20/165, të datës 12 tetor 2023.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që biografinë e kandidatit të propozuar t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/168
Datë: 23.10.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 15, paragrafit 1 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe me Ligjin Nr.08/L-235, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,675,150 € (një milion e gjashtëqindeshtatëdhjetepesë mijë e njëqindpesëdhjetë euro) deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht për vitin 2023, për N. P. TREPÇA Sh. A.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Ekonomisë, me kod 213, nga nën programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:
 - 2.1. Administrata Qendrore me kod 11313, merret shuma prej 298,831 € (dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e një euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime" shuma e ndikuar negativisht është -24.90%.
 - 2.2. Zyra e Ministrit me kod 11413, merret shuma prej 11,579 € (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.90%.
 - 2.3. Departamenti i Energjisë me kod 43800, merret shuma prej 64,740 € (gjashtëdhjetë e katër mijë e shtatëqind dyzet euro) nga kategoria e shpenzimeve "mallra dhe shërbime", shuma e ndikuar negativisht është -24.90%.
 - 2.4. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë me kod 27400, nga kategoria e shpenzimeve "shpenzime kapitale", mjetet merren nga projekti "Programi i zbatimit të masave të EE" me kod 15372, shuma prej 1,300,000 € (një milion e treqind mijë euro), shuma e ndikuar negativisht është -19.18%.
3. Mjetet buxhetore sipas pikës 2. të këtij vendimi, transferohen në nën programin Minierat e Trepçës me kod 22800, në kategorinë e shpenzimeve "subvencione dhe transfere".
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë